



Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për programin e angazhimit në punë – punëve publike, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datën **16.04.2018** bën

## **SHPALLJE PUBLIKE**

**për**

### **NJËSITË E VETADMINISTRIMIT LOKAL DHE QYTETIT TË SHKUPIT**

U bëhet thirrje njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit, të cilat janë të interesuara për organizimin e punëve publike nëpërmjet angazhimit të personave që janë të identifikuar si të papunë me kualifikime të ulëta në projektet me karakter infrastrukturor dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor, që të paraqiten në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendrën e punësimit ku është selia e NJVL-së.

Për realizimin e këtij programi është paraparë mbështetje financiare në një shumë prej 400 denarë për secilin person të angazhuar gjatë ditës, duke përfshirë këtu edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

Mjetet do të transferohen pas kalimit të angazhimit të punës në njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit.

Numri maksimal i personave të mbështetur për secilën komunë është 50 persona dhe këta do të angazhohen me punë nga ana e komunave dhe qytetit të Shkupit për periudhën më së shumti deri 22 ditë.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë.

Shfrytëzuesit e të drejtës së ndihmës sociale gjatë kohëzgjatjes së angazhimit do ta kenë aktive të drejtën e tyre për shfrytëzimin e kësaj ndihme.

Njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qyteti i Shkupit paraqitjen e bëjnë me dorëzimin e fletëparaqitjes së formularit të unifikuar në formë të shkruar më së voni deri më **27.04.2018** në klubin e punës së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë – qendrën e punësimit ku ndodhet selia e NJVL-së.

NJVL e interesuar dhe Qyteti i Shkupit mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet në qendrat e punësimit çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 si dhe në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë ([www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ([www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)).

AGJENCIA E PUNËSIMIT

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË